

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Fillim Skoro gjyqtar referues e Have Haliti, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarit A.G., nga Skenderaj, për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së PTH-DKR në Mitrovicë, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.37/2017, të dt.12.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 29.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e PTH-DKR në Mitrovicë dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore -DKR në Mitrovicë, P.nr.37/2017, të dt.12.09.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore –DKR, në Mitrovicë, P.nr.37/2017, të dt.12.09.2017, i akuzuari A.G., nga Skenderaj, është liruar nga akuza për veprën penale marrja e ryshfetit, nga neni 343 par.1 të KPK, në pajtim me dispozitën e nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP, për shkak se nuk është provuar se i akuzuari, ka kryer veprën penale, për të cilën është akuzuar.

Shpenzimet e procedurës penale, kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të asaj gjykate.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

-Prokuroria Themelore-DKR në Mitrovicë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën dhe ta anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj PPA/I.nr.450/17, të dt.16.10.2017, duke u sqaruar përkritazi me ankesën e PTH-DKR në Mitrovicë, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e PTH-DKR, në Mitrovicë dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP, në këtë çështje penale nuk caktoi seancën e kolegjit, për arsye se kemi të bëjmë me aktgjykim lirues dhe mbajtja e seancës së kolegjit nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, duke vlerësuar pretendimet ankimore të PTH-DKR në Mitrovicë, edhe sipas detyrës zyrtare, e bashkë me te edhe aktgjykimin e ankimuar, e duke marr parasysh edhe mendimin me shkrim të paraqitur nga ana e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës gjeti se:

Ankesa e PTH-DKR në Mitrovicë, është e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

PTH-DKR në Mitrovicë, në ankesën e saj pretendon se aktgjykimi është përfshirë në shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale në bazë të nenit 384 par.1 nën.1.12 KPP-ës për arsye se i akuzuari A.G. është liruar nga akuza, për arsye se aktgjykimi është i paqartë i pakuptueshëm, lidhur me faktet vendimtare dhe gjykata e shkallës së parë, nxjerr përfundime të gabuara pa dhënë arsye të qarta dhe të plotë me lirimin e të akuzuarin A.G., e nga akuza për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK. Gjykata bënë vetëm renditjen e provave në shqyrtimin gjyqësor, nuk paraqet në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Gjykata është përqendruar vetëm në deklaratën e të akuzuarit A.G., se kur është mbajtur provimi a ishte është parë i akuzuari në stacion policor në Mitrovicë apo edhe në Skenderaj. Edhe gjendja faktike sipas ankesës nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe gjykata besimin ia fal deklaratës së dëshmitarëve V.K. e B.S., të cilët deklarojnë se asnjëri prej tyre të akuzuarit A.G., nuk i kanë premtuar ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër, për kalimin e testit të patentë shoferit, dhe ekzistojnë kundërthënie ne mes të dëshmitarëve të dhënë në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë deklaratën e dëshmitarit V.K., i cili në polici ka bërë identifikimin e personave, në shqyrtimin gjyqësor i beson po të njëjtit dëshmitar, se nuk e njeh asnjë person që e ka identifikuar më parë, e po ashtu gjykata nxjerr konkludim të gabuar edhe mbi gjendjen faktike se dëshmitari B.S., deklaron se çmimi për test teorik dhe praktik është 350Euro, e sipas ankesës nga provat, këto të holla i ka marrë i akuzuari.

Gjykata e Apelit, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e PTH-DKR në Mitrovicë, e sipas detyrës zyrtare, në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, gjen se sipas këtyre bazave ankimore ankesa është e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 304 par 1 të KPP, gjen se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe të plotë rreth argumentimit se i akuzuari A.G., nuk është kryes i veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK, gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plotë se i akuzuari A.G., nuk ka kërkuar nga i dëmtuari V.K., shumën e të hollave prej 350Euro, për të kaluar pjesën teorike të provimit për patentë shofer, mirëpo, këto të holla në shumë prej 350Euro, janë paguar për dhënien e provimit për patentë shofer për pjesën teorike dhe praktike, e të cili fakt e vërteton edhe dëshmitari B.S., e kjo mbështetet edhe nga deponimi e të dëmtuarit V.K., i cili në shqyrtimin gjyqësor, prej fotografive të prezantuara 1 deri në 12, deklaron se nuk e njeh asnjërin prej personave, përfshirë këtu edhe të akuzuarin A.G..

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe të plotë dhe ka vlerësuar drejtë të gjitha provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe ka nxjerr

konkludime të drejta se i akuzuari A.G., nuk është fajtor për veprën penale të marrjes së rryshfetit, për arsye se nga provat e nxjerra, nga dëgjimi i dëshmitarëve, nuk është provuar me asnjë provë se i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, e në mbështetje të kësaj është deklarata e vet të dëmtuarit, i cili në cilësinë e të pandehurit në polici ka deklaruar se e ka njohur të akuzuarin në bazë të fotografisë, mirëpo, në shqyrtimin gjyqësor kur është marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarit deklaroi se fotot të cilat janë prezantuar, e në mesin e të cilëve kanë qenë dymbëdhjetë persona ku ka qenë edhe fotoja e të akuzuarit A.G., deklaroi se të akuzuarin A.G., nuk e ka njohur. Nga ajo që u tha më lartë rezulton se nuk ka asnjë provë të besueshme që do të vërtetonte se i akuzuari A.G., ka kryer veprën penale si pretendohet në ankesën e PTH-DKR në Mitrovicë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP.

Pretendimet ankimore se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë e të paraqitur në ankesë, nuk është bazuar për arsye se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar se i dëmtuari V.K., ka paguar shumën prej 350Euro, për pjesën teorike dhe praktike për dhënien e patentë shoferit, kjo vërtetohet nga fletëparaqitja për provim, certifikata e Kryqit të Kuq, vërtetimi i dt.19.03.2010, të lëshuar në emër të dëmtuarit V.K., certifikatën shëndetësore në emër të V.K., vërtetimin se auto shkolla "NNi", si dhe vërtetimi se është regjistruar me numër biznesin 70482789 auto shkolla "NNi", në emër të akuzuarit A.G., si biznes individual, si dhe nga dëshmitë e dëshmitarëve - të dëmtuarit V.K., i cili është marrë tani në pyetje në shqyrtimin gjyqësor në cilësinë e dëshmitarit, i cili radhazi pohon dhe vërteton se personat nga të cilët i ka marrë pajisjet nuk i njeh, e në mesin e të cilëve persona ka qenë edhe i akuzuari Afrim dhe se të akuzuarit Afrim nuk i ka dhënë asnjë dhuratë apo të holla me qëllim që të kalojë testin për patentë shofer. Në favor të përfundimit të tillë gjykata ka nxjerr përfundime të drejta dhe të qarta, është edhe dëshmia e dëshmitarit B.S., i cili vërteton se i akuzuari A.G., nuk ka kërkuar kurrfarë të holla, përveç se i dëmtuari ka kryer pjesën praktike dhe teorike sipas rregullave për dhënien e provimit për patentë shofer dhe çmimi është paguar për dhënien e provimit për patentë shofer.

Nga kjo rezulton se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga gjykata e shkallës së parë, e cila është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dobi të akuzuarit A.G., janë të pabazuara dhe gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vepruar në bazë të provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, e me marrjen e aktgjykimit lirues në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP, për arsye se nuk është provuar se i akuzuari A.G., ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Të hollat të cilat i ka paguar i dëmtuari V.K., kanë qenë të holla të cilat janë paguar për dhënien e provimit për patentë shofer. Nga kjo del se gjykata e shkallës së parë, në bazë të asaj që është cekur në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje penale, drejt ka aplikuar ligjin penal.

Prandaj, nga arsyet e përshkruara më lartë u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, ndërsa ankesa e PTH-DKR në Mitrovicë, të refuzohet si e pa bazuar, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.480/2017, me dt.29.11.2017

Procesmbajtësi,

Anëtarët e Kolegjit,

Kryetare e Kolegjit,

Eroll Gashi

Fillim Skoro

Tonka Berishaj

Have Haliti